



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive
- * Aktivitetet për trajnues-profesionet e lira
- * Aktivitetet për trajnues

Maj 2023

Aktivitetet e përgjithshme

Ceremoni për shpërndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit e Programit të Trajnimit për Trajnues në fushën e Ndërmjetësimit



Me 02 maj 2023, Akademia e Drejtësisë e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së, mbajti Ceremoninë për ndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit e suksesshëm të Programit për Trajnim të Trajnuesve në fushën e Ndërmjetësimit zhvilluar nga Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së.

Ky program tashmë 2 vjeçar, kishte për synim të forcojë profesionin e ndërmjetësuesit në institucionet e Drejtësisë në Kosovë dhe të ndihmojë Akademinë e Drejtësisë në identifikimin dhe trajnimin sipas standardeve më të larta të 13 ndërmjetësues të cilët në të ardhmen do të trajnojnë ndërmjetësuesit në Sistemin e Drejtësisë në Kosovë.

Me rastin e përfundimit me sukses të Programit të Trajnimit për Trajnues në fushën e Ndërmjetësimit në këtë ngjarje mbajtën fjalim rasti Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, z. Enver Fejzullahu, z. Peter Swanson – Menaxher i zyrës për menaxhim dhe parandalim të konfliktit, Shërbimi Federal i Ndërmjetësimit dhe Pajtimit, znj. Alyson Grunder – zëvendës Ambasadore e Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë, z. Blerim Sallahu, zëvendës Ministër i Drejtësisë, z. Veton Shabanaj, zëvendës Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Qerim Ademaj, zëvendës Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Christopher Thompson nga Programi për Drejtësi Komerciale, USAID, dhe znj. Ganimete Xhelili – Kryetare e Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës.



Nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB



Prishtinë 3 maj 2023, z. Enver Fejzullahu - Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë priti në një takim miqësor z. Veton Vula, Dekan dhe z. Fatmir Qollaku, profesor në Fakultetin Juridik të Kolegjit AAB.

Qëllimi i këtij takimi ishte nënshkrimi i

memorandumit të mirëkuptimit për mbajtjen e praktikës dhe vizitave studimore të studentëve të Fakultetit Juridik të këtij Kolegji në Akademinë e Drejtësisë.

Të dy palët u pajtuan të organizojnë aktivitete të përbashkëta profesionale me qëllim të shkëmbimit të praktikave në drejtim të rritjes së cilësisë së programit të trajnimit praktik për studentët. Dhe gjithashtu u pajtuan që është e domosdoshme që të kenë projekte të përbashkëta kërkimore, shkencore dhe hulumtuese.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e IX)- 2022-2023

Gjatë muajit maj për 5 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar gjithsej 19 sesione të trajnimit teorik dhe 6 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, moduli: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese dhe Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale.

Në kuadër të modulit: Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë realizuar 3 sesione trajnuese nga nën moduli: “Udhëzuesi për politikën ndëshkimore” nga i cili janë trajtuar rrethanat për ashpërsimin e dënimit, të zbutjes së dënimit si dhe udhëzuesi për caktimin e dënimeve me gjobë.

Nga moduli: “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar” janë realizuar 6 sesione trajnuese për “KEDNJ” në të cilat janë trajtuar neni 5, 6 dhe neni 10 i kësaj konvente. Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe 2 sesione trajnuese për të drejtën e BE-së me theks te roli dhe kompetencat e Bashkimit Evropian dhe burimet e së drejtës së BE-së.

Në kuadër të modulit: “Shkathtësitë personale

dhe ndërpersonale” janë realizuar 3 sesione trajnuese për arsyetimin e vendimeve gjyqësore me ç’rast janë ofruar shpjegime sa i përket arsyetimit të vendimeve, akteve akuzuese, shkrimit ligjor dhe detyrimit për arsyetimin e akteve të prokurorit.

Nga moduli:” Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese” janë realizuar 3 sesione trajnuese me fokus te “Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore” në kuadër të cilave janë ofruar shpjegime të nevojshme sa i përket fjalës hyrëse, marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë dhe të tërthorët si dhe për fjalën përfundimtare. Të gjitha këto janë ilustruar përmes rastit praktik dhe simulimit gjyqësor. Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe 2 sesione nga Kodi i Drejtësisë për të mitur” me ç’rast janë shtjelluar: dispozitat e përgjithshme me të cilat e karakterizojnë procedurën penale ndaj të miturit dhe masat e diversitetit.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.



Trajnimi praktik për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e IX)-2022-2023

Gjatë muajit maj, 45 gjyqtarët e gjeneratës së IX kanë vijuar sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar.

Gjatë kësaj periudhë janë realizuar gjithsej 21 ditë trajnimi praktik, pjesë kjo e trajnimit e cila është realizuar nën mbikëqyrjen e gjyqtarit/mentor.

Në kuadër të këtij trajnimi, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë shqyrtuar lëndët dhe kanë asistuar në të gjitha aktivitetet gjyqësore që kanë qenë sipas planit të punës

gjatë muajit prill duke ndërmarrë veprimet e duhura për lëndët përkatëse me rastin e praktikës.

Mentorët kanë qenë të koordinuar me Akademinë e Drejtësisë në përmbushje të trajnimit praktik sipas kompetencave të përcaktuara me Programin Trajnues.

Gjithashtu vijueshmëria e tyre në trajnimin praktik gjatë muajit ka qenë e rregullt dhe me këtë është përmbush trajnimi praktik sipas kalendarit trajnues.

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e X)-2023-2024



Gjatë muajit maj për 29 gjyqtarët e sapo emëruar (një prej tyre nga komuniteti boshnjak) janë realizuar gjithsej 42 sesione të trajnimit teorik nga moduli: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale si dhe nga moduli: E drejta civile, ekonomike dhe administrative.

Në kuadër të Modulit: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar është realizuar 1 sesion trajnues për: “Drejtësinë Kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial” me ç’rast janë trajtuar: vendimet e Gjykatës Kushtetuese

dhe 4 sesione nga nën moduli: “E drejta e BE-së” nga të cilat janë trajtuar: Roli dhe kompetencat e Institucioneve të BE, burimet e BE-së, vendimmarrja e BE-së, qytetaria e Bashkimit Evropian dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Nga Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale, janë realizuar 4 sesione trajnuese nga nën moduli: “Ngritja e shkathtësive sociale dhe menaxhimi i stresit”. Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese janë trajtuar aspekte me rëndësi rreth individit dhe mjedisit social, motivimit, menaxhimit të kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit dhe menaxhimi i stresit në punë. Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe 4 sesione për Menaxhimin e rasteve dhe vlerësimin e performancës.

Me rastin e këtyre sesioneve janë trajtuar: Rëndësia dhe parimet e menaxhimit të rrjedhës së lëndës, qëllimi i punës së gjykatave dhe metodat themelore në menaxhimin e lëndëve si dhe kontrolli i shtyrjes, udhëheqësia dhe masat e performancës së gjyqtarëve, vlerësimi i performancës së gjyqtarëve dhe Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

Në kuadër të modulit: E drejta civile, ekonomike dhe administrative janë realizuar 4 sesione trajnuese nga nën moduli: “E drejta civile”. Vëmendje e veçantë në këto sesione i’u kushtua nocionit, parimeve dhe burimeve të së drejtës civile, mardhëdhënieve juridiko-civile dhe klasifikimi i të drejtave subjektive civile, punëve juridike, modifikimi i tyre dhe ndarja punëve juridike, si dhe përfaqësimit dhe pavlefshmërisë së punëve juridike. Në vijim të këtij moduli janë realizuar 11 sesione trajnuese nga nën moduli “Procedura kontestimore-pjesa e parë”, në kuadër të cilit janë trajtuar: llojet e aktgjyqimeve, përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës, mjetet e rregullta, mjetet e jashtëzakonshme, raste nga praktika gjyqësore, parimet e procedurës kontestimore, shqyrtimet e përgjithshme lidhur me kompetencën, përbërja e rregullt e gjykatës dhe përjashtimi i gjyqtarit, palët në procedurën kontestimore, parashtrësat dhe dërgimi i shkresave.

Nga nën moduli “Procedura përbarimore “ janë realizuar 2 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar: fillimi i procedurës së përbarimit, kompetencat dhe vendimet e organit përbarues dhe bazat juridike për caktimin e përbarimit.

Nga nën moduli: “Procedura kontestimore-pjesa e dytë janë realizuar 9 sesione trajnuese lidhur me: paraqitjen padisë në gjykimin e shkallës së parë, shqyrtimin paraprak të padisë, bashkëndërgjyqësia dhe pjesëmarrja e personit të tretë në gjykim, seanca përgatitore dhe pajtimi gjyqësor, shqyrtimi kryesor dhe dëshmitarët, ekspertët dhe palët, sigurimi i kërkesë padisë, ndërprerja dhe posedimi i procedurës, procedura e posaçme kontestimore,

Nga nën moduli: “Procedura jokontestimore” janë realizuar 3 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar: dispozitat e përgjithshme të procedurës jokontestimore, rregullimi i gjendjes personale dhe familjare dhe hartimi i vendimit në procedurën jokontestimore dhe mjetet juridike.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik gjyqtarët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikatat më të mira në situatat përkatëse.



Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024

Gjatë muajit maj për 21 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar gjithsej 16 sesione të trajnimit teorik dhe 6 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar dhe Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale.

Në kuadër të modulit: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar janë realizuar 3 sesione sesione trajnuese për “Drejtësinë Kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial” me ç’rast janë trajtuar: burimet e së drejtës Kushtetuese dhe Roli i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale është realizuar 1 sesion trajnues për “Rregullat e komunikimit” me ç’rast janë trajtuar komunikimi dhe bazat e komunikimit. Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe 4 sesione trajnuese me fokus te “Ngritja e shkathtësive sociale dhe menaxhimi i stresit” përmes të cilave janë ofruar shpjegime të hollësishme për mjedisin social, motivimin, menaxhimimin e kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit dhe menaxhimi ti stresit në

punë. Gjithashtu edhe 4 sesione trajnuese për “Menaxhimin e rasteve dhe vlerësimin e performancës” me theks të veçantë te menaxhimi dhe karakteristikat e tij, planifikimi si funksion kryesor i menaxhimit të rasteve, SMILI-i si dhe matja e performancës së prokuroti.

Në kuadër të modulit: Kodi Penal i Republikës së Kosovës janë realizuar 2 sesione trajnuese nga nën moduli: “Kodi Penal-pjesa e përgjithshme” nga të cilat janë trajtuar vepra penale dhe përgjegjësia penale dhe nocioni i veprës penale. Në vijim të këtij moduli është realizuar edhe 1 sesion për “Kodin Penal-pjesa e veçantë” me ç’rast janë ofruar shpjegime të nevojshme për veprat penale kundër ekonomisë dhe 1 sesion trajnues për: “Krimi kibernetik” me theks te shoqëria e informacionit dhe krimi kibernetik.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

E drejta në gëzimin paqësor të pronës-Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr1. I KEDNJ

Më 02 Maj 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “E drejta në gëzimin paqësor të pronës-Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr 1 i KEDNJ-së”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me zbatimin e standardeve të GJEDNJ-së në praktikën e gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës sa i përket kontesteve lidhur me pronën dhe harmonizimi i praktikës gjyqësore.

Trajnimi në fillim u fokusua në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 1. I Protokollit 1., si dhe mënyrën e interpretimit që bënë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Në vazhdim vëmendje e veçantë i është kushtuar kushteve për ndërhyrjen në të drejtën e pronës për arsye të interesit publik të cilat janë ilustruar me vendimeve relevante të

GJEDNJ-së.

Me rastin e këtij trajnimi janë ofruar udhëzime praktike të përdorimit të përmbledhjes së vendimeve të GJEDNJ-së nga ana e gjyqtarëve në rastet përkatëse. Po ashtu janë ofruar udhëzime mbi hapat që duhet zbatuar gjykata për të identifikuar shkeljet eventuale që mund të bëjë shteti në gëzimin paqësor të pasurisë dhe mjetet juridike efektive në mbrojtje të kësaj të drejte.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 29 gjyqtarë të cilët vinin nga radhët e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykata Komerciale dhe Gjykatat Themelore si dhe 1 prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.



Trajnim: Përdorimi i Provës Balistike

Më 03 Maj 2023, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Përdorimi i Provës Balistike”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për provat Balistike dhe përdorimi dhe administrimi i drejtë i tyre në procedurë gjyqësore.

Trajnimi në fillim u fokusua në rolin dhe rëndësinë e përdorimit të provave balistike për zbulimin, fiksimin dhe ekzaminimin e gjurmëve të lëna nga armët e zjarrit, municionet që përdoren prej tyre dhe identifikimin e armës së zjarrit në bazë të gëzhgjës së predhës, si dhe metodat e mjetet për përcaktimin e gjendjes teknike të armës së zjarrit dhe të fenomeneve të qitjes me qëllim që të zgjidhen problemet që lindin në hetimin e gjykimit të çështjeve penale

Me rastin e këtij trajnimi është prezantuar Sistemi EVOFINDER i cili mundëson lehtë regjistrimin e imazheve dixhitale të gëzhgojave

dhe plumbave nga libraria e rasteve të hapura, armëve të testuara dhe atyre të regjistruara. Këtë sistem siç u tha gjatë trajnimit e posedojnë të gjitha shtetet e zhvilluara të rajonit dhe do të përfshijë edhe Shqipërinë dhe më vonë edhe shtetet që ende nuk e kanë këtë sistem ashtu siç është paraparë në kuadër të objektivave të Udhërrëfyesit për AVLE-2024.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësinë e shqyrtimit të rasteve nga praktika gjyqësore e Gjykatës në Lyon si dhe rasteve nga Agjencioni i Forenzikes në Kosovë me ç’rast u shkëmbyen përvojat dhe praktikat më të mira në ekzaminimin dhe përdorimin e tyre gjatë hetimit dhe gjykimit të rasteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 3 gjyqtarë dhe 5 prokurorë nga niveli themelor, 2 hetues nga Policia e Kosovës dhe 1 ekspert nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë.



Trajnim: Kompensimi i viktimave të krimit-Ndryshimet ligjit

Më 04 Maj 2023, në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT, në kuadër të trajnimeve të vazdueshme është realizuar trajnimi me temë “Kompensimi i viktimave të krimit - Ndryshimet e ligjit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor rreth kompensimit të viktimave në Kosovë sipas kornizës ligjore në fuqi.

Gjatë trajnimit është diskutuar për Ndryshimet në ligjin për kompensimin e viktimave të krimit me theks te procedurat e kompensimit dhe referimit të viktimave në programin e kompensimit; vendimet e komisionit për kompensimin e viktimave të krimit si dhe Kërkesa për kompensim-Formularët.

Në pjesën e dytë të trajnimit pjesëmarrësit patën rastin të pajisen me shembuj të kërkesave të parashtruara për kompensimin dhe shembuj

të vendimeve të Komisionit për kompensimin e viktimave të krimit.

I gjithë fokusi i trajnimit ishte në ndryshimet e propozuara në ligj lidhur me përmirësimin e qasjes në programin e kompensimit të viktimave, kategoritë e veprave dhe viktimave që kanë të drejtën për kompensim të menjëhershëm, ndryshimet në llojet e dëmeve të kompensueshme, zgjerimi i afateve, ndryshimet në funksionimin e Komisionit dhe lehtësimet në aspektin procedural.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 8 gjyqtarë, 3 prokurorë, 12 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive si 3 zyrtarë nga Zyra për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave.



Trajnim: Protokoli për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale

Me 4-5 maj, 11-12 maj, si dhe 18-19 maj 2023, në mbështetje të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë janë realizuar tri sesione trajnuese mbi zbatimin e Protokollit për Trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.

Sesioni i parë është dedikuar për regjionin e Mitrovicës dhe Pejës. Sesioni i dytë për regjionin e Gjilanit, Ferizajit dhe Gjakovës, ndërkaq sesioni i tretë për regjionin e Prishtinës dhe Prizrenit.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjithë akterëve relevantë për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale sipas standardeve të përcaktuara në Protokollin Shtetëror të Trajtimin të Rasteve të Dhunës Seksuale në Kosovë.

Fokusi i këtyre trajnimeve ishte rreth përmbajtjes dhe qëllimit të Protokollit si dokument pune dhe mjet praktik i cili qartëson veprimet që duhet të ndërmerren gjatë një rasti nga të gjithë akterët, duke filluar nga Policia e Kosovës, Mbrojtësit e Viktimave, Mjekësia Ligjore, Prokuroria dhe Gjykata. Vëmendje e veçantë i është kushtuar parimeve mbi të cilat udhëhiqet ky protokoll i cili kërkon koordinimin multisektorial dhe qasjen efektive dhe të përqendruar te viktimat.

Gjatë gjithë sesioneve të trajnimit, pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit dhe ndarjes së përvojave, sfidave dhe shqetësimet

në trajtimin e këtyre rasteve të ndjeshme. Nga të gjithë njëzëri u theksua se duhet të forcohet komunikimi ndërinstitucional në mënyrë që rastet të zgjidhen në mënyrë meritore dhe t'i jepet fund paragjyqimeve shoqërore ndaj të mbijetuarve të dhunës seksuale.

Në muajt në vijim, Misioni së bashku me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe Njësinë për Trajnim të Policisë së Kosovës, do të zhvillojnë një planprogram të standardizuar për zyrtarët që merren me rastet e dhunës seksuale.

Përfitues të sesionit të I-rë nga regjioni i Mitrovicës dhe Pejës ishin 15 pjesëmarrës. Prej tyre 1 gjyqtarë, 1 prokuror, 1 zyrtarë ligjor i prokurorisë, 3 mbrojtës të viktimave, 2 ekspert mjeko ligjor dhe Këshilltarja Politike e Ministrisë së Drejtësisë

Përfitues të sesionit të II-të nga regjioni Gjilanit, Ferizajit dhe Gjakovës ishin 24 pjesëmarrës. Prej tyre 4 gjyqtarë, 4 prokurorë, 3 mbrojtës të viktimave, 4 nga Instituti i Mjekësisë ligjore dhe 9 zyrtarë policor.

Përfitues të sesionit të III-të nga regjioni i Prishtinës dhe Prizrenit ishin 24 pjesëmarrës. Prej tyre 5 gjyqtarë, 6 prokuror, 4 mbrojtës të viktimave, 4 nga Instituti i Mjekësisë ligjore si dhe 5 zyrtarë policor.

Trajnim mbi Leadershipin dhe Menaxhmentin e Gjykatës Komerciale

Më 10 maj 2023, në bashkëpunim me programin e USAID- Drejtësia Komerciale është realizuar trajnimi mbi Leadershipin dhe Menaxhmentin për stafin menaxhues të Gjykatën Komerciale.

Qëllimi i trajnimit ishte forcimi dhe avancimi i njohurive të menaxhmentit të Gjykatës Komerciale lidhur me konceptet themelore të udhëheqjes, përgjegjësitë e menaxhimit të burimeve dhe kapaciteteve në dispozicion në funksion të zbatimit më të mirë të fushëveprimit të kësaj gjykatë.

Gjatë trajnimit janë trajtuar tipet e leadershipit, menaxhimi i administratës, bashkëpunimi i menaxhmentit brenda gjykatës, pavarësia dhe llogaridhënia, planifikimet afatgjate etj.

Gjithashtu u diskutuan edhe parimet e menaxhimit, vizioni dhe autenticiteti i udhëheqësit të

gjykatës, monitorimi dhe stimulimi i stafit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar problemeve dhe sfidave gjatë punës si dhe diskutimit më të zgjeruar mes stafit nga i gjithë zingjiri hierarkik.

Metodologjia e zbatimit të trajnimit ishte e stilit të kombinuar duke përfshirë diskutime interaktive mes pjesëmarrësve dhe trajnuesve si dhe përdorimin e rasteve studimore.

Trajnuesi në këtë trajnim ishin znj. Zlaty Mihailova dhe z. Jim Haines, ekspert të angazhuar nga Programi i USAID.

Përfitues të trajnimit ishin menaxhmenti i Gjykatës Komerciale duke përfshirë Kryetarin e Gjykatës, Administratorin, Kreun e Njesisë Ligjore të Gjykatës Komerciale si dhe përfaqësues të USAID dhe përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë.



Trajnim: Program i Specializuar i Trajnimit-Krimet e Luftës- Sesioni I



Më 10-11 Maj 2023, në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Krimet e Luftës – Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur me legjislacionin penal në Kosovë i cili trajton veprat penale të krimeve të luftës, e po ashtu edhe legjislacionin penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe zbatimi i drejtë i tyre në praktikë për zgjidhjen meritore të rasteve përkatëse.

Në ditën e parë trajnimi u fokusua në shpjegime të hollësishme sa i përket rezultateve dhe sfidave aktuale në gjykimin e krimeve të luftës, aktakuzat e para në mungesë, përdorimin e provave me shkrim dhe deklaratave të dëshmitarëve në vend të provave gojore si dhe për aspekte tjera të rëndësishme që lehtësojnë zbatuesit e ligjit në zgjidhjen meritore të krimeve të luftës si qasja e lire në përdorimin e dokumenteve publike nga gjyqtarët, hulumtimi i data bazës së Tribunalit të Hagës dhe Dhomave të Specializuara si dhe ndërhyrjet nga organet e jashmtme dhe si të trajtohen ato.

Në ditën e dytë trajnimi u përqendrua në konceptet themelore të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe përgjegjësisë komanduese sipas praktikës së TPNJ-së dhe marrjen e provave në vendin ku është e

mundur. Në vijim u diskutuan edhe vendimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit në zbatimin e të drejtës penale ndërkombëtare në juridiksionin e Kosovës.

Gjyqtarët, prokurorët dhe pjesëmarrësit tjerë patën mundësi që të shkëmbejnë përvojat me ekspertë ndërkombëtarë në ndjekjen e krimeve të luftës sipas formave të përgjegjësisë komanduese dhe të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

Vëmendje e veçantë iu kushtua gjykimit në mungesë dhe ndryshimeve legjislative në raport me gjykimin në mungesë e cila do të shkaktojë vështirësi dhe sfida të mëdha gjatë trajtimit të rasteve të krimeve të luftës. Sipas këtyre ndryshimeve këto vepra penale të përcaktuara në nenin 104 të Kodit Penal, gjykimi në mungesë mund të mbahet edhe pa u plotësuar kriteret e parapara në këtë nen për praninë e të akuzuarit, nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues bindet se janë bërë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar të akuzuarin për shqyrtimin gjyqësor dhe për ta siguruar praninë e tij. Në këtë rast, i akuzuari përfaqësohet nga mbrojtësi gjatë tërë procedurës penale, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë. Nenet 11 dhe 56 të këtij Kodi në lidhje me mbrojtjen e detyrueshme zbatohen përshtatshmërisht.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 5 gjyqtarë, (3 nga Apeli dhe 2 nga Gjykata Themelore), 3 prokurorë (2 nga Prokuroria Speciale dhe 1 nga Prokuroria Themelore) 7 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga Prokuroria Speciale si dhe 5 zyrtarë policor.

Trajnim: E drejta e Azilit sipas legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë



Më 10-11 maj 2023, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “E Drejta e Azilit sipas legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtarë” në kuadër të PTV-së. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtarë mbi azilin dhe zbatimin e drejtë të tij në praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat mbi: Parimet e Konventës së vitit 1951 në lidhje me të drejtat e refugjatëve dhe parimet e Protokollit të vitit 1967; Zbatimi i dispozitave të Ligjit për Azilin i Kosovës; Udhëzuesi për praktikën gjyqësore të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (Emigracioni) dhe praktikën e GJEDNJ; Praktika gjyqësore nacionale dhe rajonale mbi paditë për njohjen e statusit të refugjatit si dhe krahasimi me rastet e Gjykatës së Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan temat mbi: Shqyrtimi i informatave nga vendi i origjinës në procedurën e azilit; dhe Shqyrtimi i praktikës gjyqësore nacionale dhe rajonale të deritashme lidhur me vendimet gjyqësore mbi paditë për njohjen e statusit të refugjatit si dhe krahasimi me rastet e GJEDNJ.

Që në fillim të trajnimit u theksua se zbatimi i legjislacionit nacional dhe ndërkombëtar për azilin dhe respektimi i kësaj të drejte paraqet sfidë të madhe për sistemin gjyqësorë në ditët e

sotme, duke potencuar se është praktikë e re në gjykata andaj edhe gjykimi i këtyre rasteve kanë një ndjeshmëri të madhe. Gjithashtu ndjeshmëria ka të bëjë me afatet, kohën si dhe aplikimin efikas të dispozitave ligjore nacionale dhe akteve ndërkombëtare të kësaj fushe.

Në vazhdim u theksua se përveç instrumenteve ndërkombëtare të cilat mbrojnë dhe proklamojnë të drejtën e azilit gjithashtu gati të gjitha shtetet garantojnë këtë të drejtë me anë të ligjeve të tyre interne. Instituti i azilit akoma nuk është përcaktuar si një e drejtë personale, me të gjitha tendencat që të përfshihet në kuadrin e të drejtave njerëzore. Më tepër azili është konsideruar si favor mirëbërës i shtetit.

Lidhur me mbrojtjen e të drejtave individuale shprehimisht u theksua se mbrojtja e të drejtave individuale të garantuara me standardet ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatit do të përbëjnë minimumin e standardeve të mbrojtjes, të cilat duhet t'i lejohen azilkërkuesit. Ligji në fuqi gjithmonë do të interpretohet në frymën e minimumit të lartpërmendur të standardeve të mbrojtjes. Instituti i azilit në Kosovë e rregullon në mënyrë të hollësishme Ligji Për Azilin.

Pas një debati lidhur me parimin e mos-dëbimit (nonrefoulment), u potencua se ky ka hyrë si praktikë në të drejtën ndërkombëtare dhe është i zbatueshëm për çdo refugjatë, azilkërkues apo të huaj që është larguar nga vendi ku ka qenë i vendosur së fundi dhe ka nevojë për strehim. Sipas këtij parimi, shtetet nuk mund ti kthejnë të huajt në territoret ku ata mund ti nënshtrohen torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues, apo ku jeta dhe liritë e të drejtat e tij mund të rrezikohen.

Në këtë trajnim u sqaruan dilema te shumta lidhur me procedurën administrative dhe procedurën gjyqësore që zhvillohet lidhur me këto çështje, si dhe u ofruan njohuri adekuate për gjyqtarët në rastet kur ata nxjerrin vendime në çështjet e azilit.

Ndër metodat kryesore që u përdoren në këtë trajnim ishin: shpjegime të pjesshme teorike; diskutime interaktive, analizë të rasteve hipotetike, raste gjyqësore nga praktika vendore dhe e shteteve të rajonit. U trajtuan edhe shembuj praktikë mbi parimet dhe rregullat kryesore të së drejtës ndërkombëtare dhe të brendshme, diskutime për mënyrat e

nxjerrjes së vendimeve të bazuara në merita për çështjet aktuale, dhe se si gjyqtarët duhet merren me ankesat në shkallë të ndryshme kur vendosin në bazë të bazueshmërisë së rastit.

Përfitues në këtë trajnim ishin 1 gjyqtare e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, 6 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor si dhe 3 zyrtarë të lartë për Azil nga Ministria e Punëve të Brendshme- Departamenti për shtetësi, azil dhe migrim.



Trajnim: Sekuestrimi dhe konfiskimi

Më 12, 19 dhe 26 maj 2023, në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar 3 sesione trajnuese regionale me temë “Sekuestrimi dhe konfiskimi” Sesioni i parë i është dedikuar regjionit Prishtinë-Mitrovicë, sesioni i dytë Prizren-Gjakovë-Pejë dhe sesioni i tretë për profesionistët ligjor nga regjioni i Gjilanit dhe Ferizajit.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zbatuesve tjerë të ligjit lidhur me ndryshimet ligjore sa i përket dispozitave të konfiskimit

Me rastin e këtyre trajnimeve vëmendje iu kushtua ndryshimeve në Kodin Penal dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me konfiskimin të cilat synojnë evitimin e sfidave dhe problemeve që janë hasur në praktikë lidhur me këtë institut. Përderisa në ish KPP-në e vjetër ka pasur afate të ndryshme tek ngrirja dhe sekuestrimi (3 respektivisht 5 ditë) dhe po ashtu ka pasur procedura të ndryshme për ngrirjen dhe sekuestrimin, me ndryshimet e reja, do të jetë shumë më i lehtë zbatimi neneve që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin, sepse është vetëm një afat (afati 7 ditësh për UNP) dhe një procedurë e vetme që duhet të ndiqet.

Gjatë këtij këtyre trajnimeve u vu në pah edhe neni 92 sipas të cilit tentohet të konfiskohet dobia pasurore e përfituar me veprë penale dhe mjeti i përdorur në kryerjen e veprës penale. Kur një gjë e tillë ndodh, atëherë procedura rreth konfiskimit përfundon në atë hap, mirëpo nëse për çfarëdo arsye dobia pasurore apo instrumentaliteti më nuk është në dispozicion për tu konfiskuar, atëherë, gjykata ka mundësinë e përcaktimit të vlerës së barasvlershme. Kur as kjo nuk është e mundur, neni 92 ka përcaktuar një mundësi shtesë që nuk ka ekzistuar më parë dhe kjo është konfiskimi i SECILËS pasuri të të pandehurit me vlerë të

barasvlershme dhe kjo pasuri mund të jetë edhe nëse bëhet fjalë për pasurinë e ligjshme të të pandehurit. Gjithashtu gjatë trajnimeve u diskutua edhe për format e sekuestrimit të cilat u ilustruan edhe me shembuj nga praktika gjyqësore përmes të cilave pjesëmarrësit nga të gjitha regjionet patën mundësinë e shkëmbimit të përvojave dhe identifikimit të praktikave më të mira.

Përfitues të trajnimit nga sesioni i parë - regjioni i Prishtinës dhe Mitrovicës ishin 5 gjyqtarë dhe 9 prokurorë kryesisht nga niveli themelor.



Përfitues të trajnimit nga sesioni i dytë - regjioni i Prizren-Gjakovë-Pejë ishin 15 gjyqtarë dhe 2 prokurorë si dhe një bashkëpunëtorë profesional.



Përfitues të trajnimit nga sesioni i tretë - regjioni i Gjilanit dhe Ferizajit ishin 9 gjyqtarë dhe 9 prokurorë si dhe 4 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor.



Program i Specializuar i Trajnimit-Pastrimi i parave dhe hetimi financiar-Sesioni II

Më 16-17 Maj 2023, në bashkëpunim me IRZ, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit - Pastrimi i parave dhe hetimi financiar - Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare me theks te ajo gjermane kundër pastrimit të parave.

Në ditën e parë është trajtuar kuadri ligjor kosovar dhe praktika aktuale e pastrimit të parave si vepër penale në lidhje me kriminalitetin e organizuar dhe sekuestrimit dhe konfiskimi i të ardhurave nga veprat penale dhe njëkohësisht një vështrim në bazat ligjore gjermane dhe praktikat më të mira të masave të sigurisë në kuadrin e hetimeve për pastrim parash dhe përgatitjes së çështjes në gjykatë.

Edhe në ditën e dytë është vazhduar me krahasimet dhe vështrimet ligjore nga të dy perspektivat sa i përket raportit ndërmjet veprës penale fillestare dhe pastrimit të parave,

mundësitë e sanksioneve sipas të drejtës penale në raport me pastrimin e parave, ndihma e ndërsjellë dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë në hetimet në lidhje me pastrimin e parave dhe roli i FIU (grup i rrjeteve ndërkombëtare që shkëmbejnë informata të inteligjencës) në luftën kundër pastrimit të parave.

Pjesëmarrësit për dy ditë me radhë patën mundësinë e studimit të rasteve praktike duke pasur për bazë jo vetëm dispozitat dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale por edhe në dispozitat e ligjit të veçantë që trajton pastrimin e parave si vepër penale, Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe njëherësh në gjetjen e praktikave më të mira. .

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 4 gjyqtarë (1 nga Apeli dhe 3 nga niveli themelor i gjykatave), 9 prokuror (1 nga PRSK, 1 nga Apeli dhe 7 tjerë nga niveli themelor i prokurorive) si dhe 3 bashkëpunëtorë profesional nga PRSK dhe 3 zyrtarë policor.



Trajnimi: Mbi vlerësimin e rrezikut në rastet e dhunës në familje

Më 16 maj 2023, në bashkëpunim me Ambasadën e SHB-se në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për prokurorët, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët policor dhe profesionistët e tjerë ligjor të regjionit të Gjakovës dhe Pejës është realizuar trajnimi me temë: “Vlerësimi i rrezikut në rastet e dhunës në familje”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të prokurorëve dhe zbatuesve tjerë të ligjit sa i përket vlerësimin të rrezikut në rastet e dhunës në familje për trajtimin e tyre në mënyrë meritore dhe në përputhje me standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.

Me rastin e këtij trajnimi, krahas shpjegimeve sa i përket fenomenit të dhunës në familje dhe përcaktimit të saj si vepër penale e posaçme, vëmendje e veçantë iu kushtua procedurave

dhe mjeteve për vlerësimin e rrezikut, vështirësitë në praktikë, komunikimi polici dhe prokurori, standardizimi i formës së vlerësimin të rrezikut dhe planifikimit të sigurisë. Gjithashtu u analizua edhe Konventa e Stambollit për parandalimin dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktike gjyqësore përmes të cilave identifikuan format e paraqitjes së dhunës në familje dhe taktikat e ndryshme të kryesve për të ushtruar pushtetin dhe kontrollin ndaj tyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 5 prokuror dhe 1 zyrtarë ligjor, 3 mbrojtës të viktimave 4 zyrtar policor si dhe 3 zyrtarë nga Qendra për punë sociale nga regjioni i Gjakoves dhe Pejes

Trajnim: Akuzimi dhe dënimi i rasteve të dhunës në familje



Më 18 Maj 2023, në bashkëpunim me EUKOJUST në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Akuzimi dhe dënimi i rasteve të dhunës në familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët merren me rastet e dhunës në familje për akuzimin dhe dënimin në proporcion me peshën e krimit dhe në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare.

Trajnimi në fillim u përqendrua në kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare për trajtimin e rasteve të dhunës në familje duke përfshirë edhe Udhëzuesit e Gjykatës Supreme të Kosovës si Udhëzimi lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje dhe Udhëzuesi për politikën ndëshkimore.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar



bashkëpunimit ndërinstitucional që duhet të kenë gjyqtarët dhe prokurorët duke përfshirë edhe akteret tjerë relevantë në mënyrë që këto raste të trajtohen në mënyrë meritore.

Në pjesën e dytë është diskutuar për vlerësimin e seriozitetit të rasteve të dhunës në familje nga gjyqtarët dhe prokurorët duke marrë parasysh natyrën specifike, vonesat e panevojshme, masat paraprake, përfaqësimi i prokurorisë në aktakuzat e dhunës në familje, kompensimi i dëmit, shqyrtimi i dosjeve të mëparshme të prokurorisë lidhur me kryesit dhe aspekte tjera të rëndësishme gjatë trajtimit të këtyre rasteve.

Fokusi i veçantë gjatë këtij trajnimi ishte edhe vështrimi i përgjithshëm i faktorëve lehtësues dhe rëndues në dënimin e rasteve të dhunës në familje dhe aktgjykimet e gjykatave në procedurë penale duke përfshirë edhe vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

Pjesëmarrësit patën mundësinë e studimit të disa rasteve hipotetike të cilat u analizuan dhe u ofruan perspektivat sa i përket cilësimit juridik dhe sanksionet në përputhje me rastet përkatëse. Përfitues të këtij trajnimi ishin 14 gjyqtarë, 3 prokurorë si dhe 1 zyrtarë ligjor të nivelit themelor.

Trajnim: Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në Familje -Konventa e Stambollit

Më 19 Maj 2023, në bashkëpunim me Organizatën Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal – CLARD dhe IKD dhe në mbështetje të Ambasadës Amerikane në Prishtinë Departamentit të Shtetit Amerikan, Byrosë së Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit INL është realizuar trajnimi me temë: “Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në familje- Konventa e Stambollit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njoftohen lidhur me Konventën e Stambollit si mjet i rëndësishëm për luftimin dhe zbatimin e praktikave të mira të rasteve të dhunës në familje.

Trajnimi u orientua në trajtimin e rasteve të Dhunës ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje, një nga format më të rënda të shkeljeve me bazë gjinore të të drejtave të njeriut në Evropë që siq është vlerësuar ende mbulohet me heshtje. Përveq kësaj u diskutua edhe për Dhunën – ndaj viktimave të tjera si fëmijët, burrat dhe të moshuarit që gjithashtu po

cilësohet si fenomen i fshehur i cili prek shumë familje dhe që nuk mund të injorohet.

Më tej u vazhdua me trajtimin e nenit 2 dhe 3 ku në bazë të nenit 2 duhet të merren hapat e duhura për të mbrojtur jetën e atyre që janë në juridiksionin e saj, e cila përfshin një detyrë parësore të shtetit për të siguruar të drejtën e jetës duke vendosur dispozita efektive të ligjit penal për të penguar kryerjen e veprave kundër personit.

Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 6 Avokatë nga gjitha regionet e Kosovës, 1 Zyrtarë për Mbrojtjen e Viktimave si dhe 1 zyrtarë policor .



Trajnim për praktikën gjyqësore në çështje nga Procedura Përmbartimore

Më 23-24 Maj 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me GIZ është realizuar trajnimi me temë “Trajnim për praktikën gjyqësore në çështje nga Procedura Përmbartimore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me diskutimin e rasteve praktike, diskutimi i vështirësive me të cilat ballafaqohen gjyqtarët gjatë procedimit të lëndëve të natyrës përmbartimore, duke qartësuar dilemat, për zhvillimin e një praktike të mirëfilltë dhe unike gjyqësore.

Gjatë këtyre dy ditëve përmes rasteve janë identifikuar problemet praktike që nga ekzaminimi i propozimit për përmbartim, roli dhe rëndësia e organit përmbartues kur është gjykata dhe kur është përmbartuesi privat, ekzaminimi i dokumentit përmbartues, vlerësimi i pretendimeve nga prapësimi atyre procedurale dhe atyre materiale, parimi i

rigorozitetit formal juridik dhe keqkuptimi në praktikë, dokumentet e besueshme që qarkullojnë sot dhe defektet e tyre në drejtim të mangësive të elementeve që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Po ashtu gjatë tryezës janë trajtuar çështjet thelbësore të procedurës së përmbartimit si për raste kur procedura fillohet tek përmbartuesi privat, ashtu edhe për raste kur procedura fillohet tek gjykata, pa përjashtuar edhe çështjet që lidhen me zbatimin e përmbartimit si dhe procedurën sipas mjeteve të goditjes.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 29 gjyqtarë, prej tyre 5 nga Gjykata e Apelit, 2 nga Gjykata Komerciale si dhe 17 zyrtarë të ndihmës juridike falas.



Trajnim: Shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim

Më 23-25 Maj 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT, është realizuar trajnimi me temë “Zhvillimi i shkathtësive të përfaqësimit në gjykim”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte i avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me përfaqësimin në gjykim, përmes elaborimit të teorisë së gjykit, dhënien e një fjale hyrëse efektive, marrjen në pyetje e drejtpërdrejt dhe e tërthortë, përdorimin e provave në gjykim, dhënës së fjalës përfundimtare si dhe argumentimi për një dëm në vend.

Në ditën e parë dhe të dytë janë trajtuar aspektet e rëndësishme të gjykit, teoria e gjykit si dhe dhënia e një fjale hyrëse. Më tutje janë elaboruar marrja në pyetje e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë, përdorimi i provave në gjykim dhe dhënia e fjalës

përfundimtare si dhe argumentimi për një dëm në vend.

Ndërsa në ditën e tretë, pjesëmarrësit patën rastin e studimit të rasteve praktike dhe përgatitjes së temave dhe strategjisë për gjykim, ku secili nga pjesëmarrësit patën mundësinë të luanin rolet në cilësi të prokurorit dhe avokatit mbrojtës të jepnin fjalë hyrëse për rastin konkret, të demonstrojnë marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë si dhe në fund fjalën përfundimtare.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive, simulimi i rasteve, incizimet me video kamerë, kritika dhe vetë Kritika.

Përfitues në këtë punëtori ishin 7 prokurorë dhe 3 avokat shtetëror.



Trajnim: Procedura përmbarimore-lejimi i përmbarimit

Më 31 Maj 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Procedura përmbarimore-lejimi i përmbarimit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me bazat juridike për caktimin e përmbarimit dhe kriteret ligjore për lejimin e përmbarimit.

Ne fokus të veçantë kanë qenë temat lidhur me bazat juridike gjatë të dy sesioneve si të paradites ashtu edhe asaj të pasdites. Sidomos dilemat që janë rreth dokumentit administrativ dhe noterial e me theks të veçantë dokumentin e besueshëm- faturën me rastin e lejimit të përmbarimit. Po ashtu, janë diskutuar edhe parimet sidomos parimi rigoroz formal.

Gjatë trajnimit janë ofruar shpjegime të hollësishme sa i përket përmbarimit të propozimit për përmbarim, për procedurën e shqyrtimit të propozimit, procedurën e caktimit të përmbarimit, përmbarjen e aktvendimit për përmbarim dhe urdhrin për përmbarim

Më tutje u tha se në rastet më të shpeshta propozimi për përmbarim paraqitet nga personat fizik ose juridik që do të thotë se edhe në procedurën përmbarimore vlen parimi i

disponimit të palës, që është një nder parimet themelore të procedurës kontestimore, pra inicimi i kësaj procedure varet nga dëshira e kreditorit, po ashtu edhe zhvillimi i mëtejme i kësaj procedure varet nga vullneti i kreditorit sepse kreditori pa pëlqimin e debitorit gjatë zhvillimit të procedurës mund të tërhiqet nga propozimi përmbarimor në tërësi apo pjesërisht dhe të përfundohet procedura dhe se propozimi pas tërheqjes mund të paraqitet prapë në gjykatë.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe përmbarimit për pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, përmbarimit të letrave me vlerë, sekuestrimit të letrave me vlerë, vlerësimit dhe shitjes së letrave me vlerë duke përfshirë edhe prapësimin, ankesën dhe mjetet e goditjes së jashtëzakonshme.


Gjatë trajnimit pjesëmarrësve iu mundësuan ushtrime të rasteve nga praktika gjyqësore që kane qenë me të shpeshta dhe me më shumë dilema përmes të cilave u inkurajuan në ofrimin e zgjidhjeve më të mira ligjore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 5 gjyqtarë, 3 avokat shtetëror si dhe 8 përmbarues privat.



Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive

Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material dhe procedural- Grupi II



Më 02-04 Maj 2023, në bashkëpunim me SAEK, janë realizuar 3 trajnime për Grupin e II-të të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive me fokus te “Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimin e drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritorë të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale është diskutuar për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si dhe Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se.

Në kuadër të këtyre trajnimeve u diskutua për shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësishë së vogël dhe përgjegjësia penale. Në kuadër të pjesës së posaçme është diskutuar për veprat

penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Në veçanti u trajtuan Politikat ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë, konflikti i interesit, përvetësimi dhe mashtrimi ne detyre, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtar. Gjithashtu u elaboruan rrethanat renduese dhe rrethanat lehtësuese për matjen e dënimit, ndalimi i dyfishimit te rrethanave për matjen e dënimit si dhe faktorët specifik te rrethanave për ta peshuar me rastin e matjes se dënimit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

02 maj 2023, Përfitues në trajnimin ishin 22 pjesëmarrës, prej tyre 9 bashkëpunëtorë profesional, 12 zyrtar ligjor dhe 1 zyrtar ekzekutiv.

03 maj 2023, Përfitues në trajnimin ishin 25 pjesëmarrës, prej tyre 9 bashkëpunëtorë profesional, 15 zyrtar ligjor dhe 1 zyrtar ekzekutiv.

04 maj 2023, Përfitues në trajnimin ishin 25 pjesëmarrës prej tyre 9 bashkëpunëtorë profesional, 15 zyrtar ligjor dhe 1 zyrtar ekzekutiv.

Trajnim: Moduli bazik-aspekti civil material dhe procedural– E drejta e punës

Më 11 maj 2023, në bashkëpunim me UNDP në kuadër të trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave është realizuar trajnimi nga Moduli Bazik-aspekti civil me temë “E drejta e punës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve profesionale e bashkëpunëtorëve profesional në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore të Ligjit të punës.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan afatet dhe procedurat për zgjidhjen e kontesteve të punës si dhe roli i gjykatës me rastin e ekzaminimit të padive në kontestet e punës, shkaqet për shkëputjen e marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës duke elaboruar nenin 67 të LP-së.

Në mënyrë të hollësishme u trajtuan:

Procedurat për mbrojtjen e të drejtave të punës, mbrojtjen e të drejtave të punësuarit brenda organeve të punëdhënësit si dhe mbrojtjen e të punësuarit në gjykatë. Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë për vendimet e gjykatës lidhur me kontestet e punës.

Metodologjia e trajnimit ishte karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 25 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat. Prej tyre 5 nga Gjykata Supreme, 8 nga Gjykata e Apelit dhe 12 të tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material dhe procedural- Grupi III



Më 15-17 Maj 2023, në bashkëpunim me SAEK, është vazhduar me Grupin e III-të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive edhe me 3 trajnime me fokus te Pjesa e Përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimi i drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritorë të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale është diskutuar për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si dhe Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se.

Në kuadër të këtyre trajnimeve u diskutua për shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësishë së vogël dhe përgjegjësia penale. Në kuadër të

pjesës së posaçme është diskutuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Në veçanti u trajtuan Politikat ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, konflikti i interesit, përvetësimi dhe mashtrimi ne detyre, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtar. Gjithashtu u elaboruan rrethanat renduese dhe rrethanat lehtësuese për matjen e dënimit, ndalimi i dyfishimit te rrethanave për matjen e dënimit si dhe faktorët specifik te rrethanave për ta peshuar me rastin e matjes se dënimit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

15 maj 2023, Përfitues në trajnimin ishin 23 pjesëmarrës, prej tyre 12 bashkëpunëtorë profesional, 9 zyrtar ligjor dhe 1 zyrtar për informim, 1 staf administrativ.

16 maj 2023, Përfitues në trajnimin ishin 26 pjesëmarrës, prej tyre 14 bashkëpunëtorë profesional, 11 zyrtar ligjor dhe 1 staf administrativ.

17 maj 2023, Përfitues në trajnimin ishin 26 pjesëmarrës prej tyre 14 bashkëpunëtorë profesional, 11 zyrtar ligjor dhe 1 staf administrativ.

Trajnim: Moduli bazik-aspekti civil material dhe procedural– E drejta e pronësore

Më 16-17 maj 2023, në bashkëpunim me UNDP është vazhduar me sesionet e radhës për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave nga Moduli Bazik –aspekti civil me theks te “E drejta pronësore/ Pengim Posedimi”.

Qëllimi i këtij trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale e bashkëpunëtorëve profesional dhe e zyrtarëve ligjor në zbatimin e drejtë të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore për zgjidhjen e drejtë të kontesteve pronësore.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e nocioni të posedimit, natyrën, llojet e posedimit, fitimi dhe humbja e posedimi. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar mbrojtjes e posedimit duke theksuar që posedimi gëzon mbrojtje juridike, askush nuk mund të cenoj pushtetin faktik në mënyrë arbitrare, por vetëm me ndihmën e organeve kompetente. Poseduesi i sendit ka të drejtë në mbrojtje nga shqetësimet (pengimet) ose nga marrja e sendit nga posedimi, ku në këtë rast

poseduesi zhvishet nga posedimi i sendit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë për Kompetencën, me ç ‘rast nga trajnuesit u njoftuan që në pikëpamje territoriale ekskluzivisht kompetente është gjykata ne territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm në të cilin ekziston posedimi. Gjithë ashtu u diskutua për llojet e padive, afatet për paraqitjen e padisë. Gjatë këtij trajnimi u elaborua servituti si një e drejtë sendore mbi sendin e huaj, ndarja e servituteve, mënyra e fitimeve të servituteve si dhe shuarja e servituteve.

Metodologjia e trajnimit ishte karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 26 bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor nga gjykatat. Prej tyre 6 nga Gjykata Supreme, 6 nga Gjykata e Apelit dhe 14 të tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti civil material dhe procedural– E drejta e detyrimeve

Më 18 maj 2023, në bashkëpunim me UNDP është vazhduar me sesionin e radhës për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave nga Moduli Bazik –aspekti civil me theks te “E drejta e detyrimeve”.

Qëllimi i këtij Trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale e bashkëpunëtorëve profesional dhe e zyrtarëve ligjor në zbatimin e drejtë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve për zgjidhjen e drejtë të kontesteve në gjykata.

Gjatë këtij trajnimi u theksua që Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve - (LMD), në mënyrë decisive nuk e ka përcaktuar nocionin e kontratës, por në dispozitën e nenit 15 përcakton së: “kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elemente thelbësore të kontratës”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite shihet qartë se në mënyrë parimore LMD nuk përcakton një moment formal si moment për tu konsideruar së është lidhë kontrata, por përcakton se kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës.

Në kuadër të këtij trajnimi u diskutua për kushtet të cilat duhet të plotësohen me rastin e lidhjes, efektet, interpretimi dhe konvalidimi i kontratave. Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë për kontratat nule, pasojat e nulitetit, mjetet e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, dëmin, bazat e përgjegjësisë dhe llojet e dëmit. Gjithashtu u diskutuan kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit, zvogëlimi i lartësisë së kompensimit për shkak të gjendjes materiale të dëmtuesit dhe të dëmtuarit për shkak të përgjegjësisë së ndarë si dhe lirimi nga përgjegjësia.

Metodologjia e trajnimit ishte karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 23 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtar ligjor nga gjykatat. Prej tyre 4 nga Gjykata Supreme, 6 nga Gjykata e Apelit dhe 13 të tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti civil material dhe procedural– E drejta e trashëgimisë dhe e drejta familjare

Më 30-31 maj 2023, në bashkëpunim me UNDP është vazhduar me 2 sesionet e radhës për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave nga Moduli Bazik –aspekti civil me theks te: “1. E drejta e trashëgimisë dhe 2. E drejta familjare”

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave lidhur me kornizën ligjore sa i përket trashëgimisë dhe nga e drejta familjare dhe zbatimi i drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritorë të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga e drejta trashëgimore u diskutua për objektin e trashëgimisë, trashëgimia në bazë të ligjit dhe radhët e trashëgimisë. Në vijim për trashëgiminë në bazë të testamentit, llojet e testamentit, pjesa e domosdoshme dhe cenimi i saj si dhe për procedurën për shqyrtimin e saj.

Në kuadër të sesioneve nga e drejta familjare u diskutua për procedurat e zgjidhjes së martesës, fazat e procedurës së shkurorëzimit, mënyrat e vendosjes në procedurën e shkurorëzimit, besimi i fëmijëve dhe mënyra e rregullimit të kontaktit me prindin tjetër, alimentacioni, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore, format e veçanta të mbrojtjes së

fëmijëve pa kujdes prindëror, birësimi, kujdestaria, statusi i fëmijëve dhe mbrojtja e tyre në rast të ndryshimit të statusit të tyre si dhe për procedurën gjyqësore për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që për çështjet që u diskutuan për dy ditë me radhë ti elaborojnë edhe përmes rasteve të shumta studimore dhe të gjejnë zgjidhjet e duhura ligjore për secilin rast.

Për trajnimin me fokus çështjet trashëgimore kanë marrë pjesë 24 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat. Prej tyre 4 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 7 nga Gjykata e Apelit si dhe 13 nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Për dy ditët me radhë në trajnim kanë marrë pjesë 24 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat. Prej tyre 4 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 7 nga Gjykata e Apelit si dhe 13 nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal procedural-Grupi I



Më 29 -31 Maj 2023, në bashkëpunim me SAEK, për Grupin e I-të të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive që kanë përfunduar sesionet nga moduli bazik aspekti material penal është vazhduar me 3 sesionet e radhës për aspektin procedural penal me theks te “Fazat e procedurës penale, Mjetet Juridike dhe procedurat e veçanta si dhe Aktakuza - shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi”.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me aspektet procedurale që kanë të bëjnë me procedurën penale.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese u diskutua për parimet, kompetencën dhe palët në procedurën penale, Veprimet parapenale dhe fazat e procedurës penale, Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit në procedurën penale, Fazat e procedurës penale, Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi.

Gjatë këtyre trajnimeve u trajtuan: Kallëzimi penal, procedura paraprake, Aktvendimi për hushje të kallëzimit penal, aktvendimi për fillimin e hetimeve, Aktvendimi për zgjerimi të hetimeve si dhe Aktvendimi për pushim të hetimeve. Në vazhdim u trajtuan Mjetet juridike, Administrimi i procedurës, Procedura për dhënien e urdhrit ndëshkimor si procedurë e veçantë si dhe Procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca. Në veçanti u trajtua Shqyrtimi gjyqësor dhe aktgjykimi.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore dhe punës në grupe të hartojnë vendimet gjyqësore, të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore lidhur me rastet përkatëse.

29 maj 2023, Përfitues në trajnim ishin 18 pjesëmarrës, prej tyre 12 ishin bashkëpunëtorë profesional, 1 udhëheqës i sektorit administrativ dhe 1 referent i lartë.

30 maj 2023, Përfitues në trajnim ishin 20 pjesëmarrës, prej tyre 14 bashkëpunëtorë profesional, 11 zyrtar ligjor dhe 1 staf administrativ, 1 udhëheqës i sektorit administrativ dhe 1 referent i lartë.

31 maj 2023, Përfitues në trajnimin ishin 20 pjesëmarrës prej tyre 15 bashkëpunëtorë profesional, 4 zyrtar ligjor dhe 1 referent i lartë.



Trajnim: Ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale

Më 30 Maj 2023, në vazhden e trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive përveç trajnimeve nga modulet bazike për aspektin penal dhe civil në bashkëpunim me EULEX, është realizuar edhe një trajnim sa i përket ndryshimeve të reja të Kodit të procedurës Penale.

Qëllimi i këtij trajnimi është që bashkëpunëtorët profesional të njoftohen me risitë esenciale të Kodit të Procedurës Penale dhe zbatimi i drejtë i tyre në praktikën gjyqësore.

Trajnimi u orientua në trajtimin dhe shpjegimin sa i përket hedhjes së kallëzimit penal me fokus te e drejta për të apeluar aktvendimin, kontrollimin dhe sekuestrimin dhe për masat e veçanta hetimore.

Më tej u vazhdua me hetimin me theks te afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklaratat në këtë procedurë si dhe për

mundësinë hetuese të veçantë.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar risive sa i përket gjyqimit në mungesë, marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarëve bashkëpunues si dhe procesurës për pezullimin e personit zyrtarë nga detyra.

Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 25 bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor nga Gjykatat dhe Prokuroritë Themelore kryesisht të regjionit të Mitrovicës dhe Ferizajit.



Aktivitetet trajnuesuese-profesionet e lira

Trajnimet për Ndërmjetësues

Më 20 dhe 24 maj 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së, ka vazhduar me 4 sesione trajnuese dedikuar zyrtarëve ndërmjetësues.

Sesioni i parë ka qenë për fushën penale, sesioni i dytë nga fusha pronësore, sesioni i tretë në fushën familjare dhe dhe sesioni i fundit në fushën komerciale.

Gjatë trajnimve, pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë rreth qëllimeve dhe kushteve të ndërmjetësimit, roli i ndërmjetësuesit, prokurorit dhe gjyqtarit në procedurën e

ndërmjetësimit në fushën penale, pronësore, familjare dhe në fushën komerciale.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe marrëveshjeve të ndërmjetësimit dhe rolit të gjykatës në vlerësimin e marrëveshjes si dhe diskutimi i rasteve praktike që lidhen me ndërmjetësimin.

Përfitues të trajnimit ishin 7 ndërmjetësues, 1 avokat dhe 1 zyrtarë nga Qendra e Kosovës për Rehabilitimin e të mbijetuarve të Torturës. përzgjedhur në programin e Trajnimit të Trajnuesve.

Aktivitetet për trajnues

Trajnim i Trajnuesve Gjyqimi i rasteve të Korrupsionit

Më 30 maj deri 1 qershor 2023, Akademia e Drejtësisë dhe CEELI Institute në Prage të Çekisë, në bashkëpunim me Lëvizjen Fol dhe IFES, janë duke realizuar trajnimin për trajnues me temë “Gjyqimi i rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte forcimi dhe avancimi i aftësive trajnuese si dhe përditësimi i metodologjisë dhe kurikules trajnuese për gjyqtaret dhe prokuroret e Republikës së Kosovës.

Zhvillimi i trajnimit është realizuar nga instruktoret trajnues z. Jonathan Hawley, Gjyqtar Magjistrat, Gjykata Federale e SHBA-së për Distriktin Qendror të Illinois dhe z. Jim Chance, Avokat i Lartë për Arsimit dhe zhvillim Gjyqësor në Qendrën Gjyqësore Federale të SHBA-s, dhe znj. Celine Calpo, Specialiste e Programeve të Trajnimit në Qendrën Gjyqësore Federale të SHBA-së.




Kurikula trajnuese është zhvilluar përditësuar nga trajnuesit e Akademisë së Drejtësisë të udhëhequr dhe mbështetur nga instruktoret e Qendrës Gjyqësore Federale të SHBA-së. Pjesë e trajnimit ka qenë edhe hartimi apo dizajnimi i kurikules trajnuese ose organizimi i programit të trajnimit, avancimi i objektivave të trajnimit me ç ‘rast trajnuesit paraqiten përmbajtjen dhe numrin e objektivave të trajnimit për sesion.

Gjithashtu gjatë trajnimit janë realizuar edhe ushtrime për aktivitetin trajnues, janë hartuar raste hipotetike, është diskutuar përmbajta dhe efektiviteti i prezantimit në PowerPoint, materialet tjera të nevojshme të trajnimit si dhe finalizimi i planit të trajnimit.

Përfitues të trajnim ishin gjyqtarë penalistë nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, trajnues të AD-së.




Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve

Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Instutucioneve Maj 2023




Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve




Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës Maj 2023






Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara Maj 2023



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660